

VENDIM
Nr.461, datë 16.4.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.343, DATË 6.6.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET QË OFRON ZYRA
SHQIPTARE PËR TË DREJTAT E AUTORIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 123 të ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Tabela 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.343, datë 6.6.2007 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me tabelën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA 1

TARIFAT PËR SHËRBIMET E OFRUARA NGA ZSHDA

NR.	EMËRTIMI I SHËRBIMIT	FORMULARI - TIP	TARIFA (NË LEKË)
1.	REGJISTRIM I SË DREJTËS SË AUTORIT PËR KRIJIMIN ORIGJINAL NGA AUTORI/AUTORËT	F7A, F7B, F7C, F7Ç, F7D, F7DH, F7E, F7Ë, F7F, F7G, F8A, F8B	1 000
2.	CERTIFIKIMI I ÇDO TË DREJTE TË REGJISTRUAR AUTORI/APO KALIM TË DREJTASH SHFRYTËZIMI	FRK, ÇDA/ÇKD	1 000
3.	APLIKIM PËR LICENCIM TË AGJENCIVE TË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV	FL 109 AK	200 000
4.	DEPOZITË FONOGRAMI	FDF	3 000
5.	INDEKSIMI I REGJISTRIMIT	FI	5 000
6.	AKTEKSPERTIMI		10 000
7.	AKTVLERËSIMI		5 000
8.	ADMINISTRIMI I MATERIALEVE DHE PAJISJEVE		500/PËR DITË QËNDRIMI
9.	EKSPERTIZË LIGJORE PRANË ORGANEVE GJYQËSORE		30 000
10.	KONSULENCË JURIDIKE		5 000